



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 17/15

Prishtinë, më 6.5.2015, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjonaj, Latif Gashi, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Ilir Deda, Bali Muharremaj dhe Enver Hoti.

Munguan: Bojan Mitić, Bardhyl Meta dhe Fikrim Damka.

Pjesëmarrës të ftuar: Avdullah Hoti - Ministër i Financave dhe Petrit Popova – Drejtor i Departamentit të Buxhetit Komunal në MF.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli dhe Merita Zogjani (Praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetari i Komisionit.

1. Shqyrtimi i Buxhetit të Komunës së Mitrovicës Veriore, Komunës së Leposaviqit, Komunës së Zveçanit dhe Komunës së Zubin Potokut për vitin 2015

Kryetari – arsyen që kam thirrur këtë mbledhje urgjente, ka të bëjë me shqyrtimin e buxhetit të Komunës së Mitrovicës Veriore, Komunës së Leposaviqit, Komunës së Zveçanit dhe Komunës së Zubin Potokut, që janë riaprovuar nga kuvendet komunale përkatëse dhe sipas procedurës qeveria i ka dërguar në Kuvend.

Avdullah Hoti – sqaroi se Komunitet e Mitrovicës Veriore, Komunës së Leposaviqit, Komunës së Zveçanit dhe Komunës së Zubin Potokut, nuk kanë arritur ta miratojnë buxhetin deri më 1 mars dhe bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, pas kësaj kohe nuk është bërë asnjë pagesë për këto komuna. Në ndërkohë, komunitet përkatëse e kanë riaprovuar buxhetin e tyre më 27.4.2015, i cili është në harmoni me qarkoret buxhetore.

Kryetari – pyeti a ka rritje të buxhetit për këto komuna nga ajo që është miratuar me ligjin e buxhetit 2015?

Ilir Deda – theksoi se nuk është korrekte që të thirremi në formë urgjente që të shqyrtojmë diçka që nuk e kemi pas materialin më herët dhe si rezultat nuk jemi të përgatitur që të vendosim për një çështje të tillë, pasi që nuk e kemi shikuar materialin. Nga ajo që shikova këtu, po shoh se është dyfishuar buxheti

për këto komuna, nga 8 milion euro në 11 milion euro. Prandaj, kërkohet një shpjegim për dyfishimin e buxhetit.

Avdullah Hoti – sqaroj se me rastin e miratimit të Ligjit të buxhetit 2015, është e përfshirë shuma prej 8 milion euro për komunat në fjalë, ndërsa, 11 milion euro kanë qenë të vendosura si rezervë në ligjin e buxhetit dhe tani pas riaprovimit të buxhetit nga komunat përkatëse, kjo shumë shpërndahej apo po bëhen përshtatjet, që është në pajtim me qarkoren e buxhetore dhe nuk kemi bërë asnjë shkelje.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni unanimitisht, Ministrisë së Financave i parqet këtë

Rekomandim

Buxheti i Komunës së Mitrovicës Veriore, Leposaviqit, Zveçanit dhe Zubin Potokut, për vitin 2015, i riaprovuar nga Kuvendi Komunal i Mitrovicës Veriore, Leposaviqit, Zveçanit dhe Zubin Potokut, me datë 27 prill 2015, të pasqyrohet në tabelat buxhetore të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015.

Mbledhja përfundoi në ora 14:08

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani